



IOM International Organization for Migration  
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

## PAKETË INFORMUESE PËR MALIN E ZI

### 1. Informacion bazë

**Kryeqyteti:** Podgorica  
**Popullsia:** 680 000  
**Sipërfaqja:** 13.812km<sup>2</sup>  
**Monedha:** Euro  
**Niveli i papunësisë:** 14.7%

### 2. Kushtet e përgjithshme të hyrjes dhe informacion për vizat

Qëndrimi i shtetasve të huaj në Malin e Zi rregullohet nga Ligji për të Huajt dhe Vendimi për Rregjimin e Përkohshëm të Vizave në Malin e Zi. Shtetasit e Republikës së Serbisë mund të hyjnë dhe të qëndrojnë në Malin e Zi me të njëjtat kushte si shtetasit e Malit të Zi (me një kartë identiteti).

Shtetasit nga Austria, Belgjika, Greqia, Danimarka, Estonia, Italia, Republika e Irlandës, Qiproja, Lituania, Letonia, Luksemburgu, Malta, Hungaria, Gjermania, Polonia, Portugalia, Sllovakia, Sllovenia, Finlanda, Franca, Holanda, Republika Çeke, Spanja, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës mund të hyjnë dhe të qëndrojnë në Malin e Zi deri në 90 ditë. Ata mund të udhëtojnë nëpër Malin e Zi me dokumente të vlefshme udhëtimi dhe një leje turistike.

Për qëllime të vizitave turistike deri në 30 ditë (individuale apo në grup), **shtetasit nga Shqipëria, Federata Ruse dhe Republika e Ukrainës mund të hyjnë dhe të qëndrojnë në Malin e Zi mbi bazën e dokumenteve të vlefshme të udhëtimit pa vizë, me leje turistike.** Leja turistike lëshohet nga organi administrativ përgjegjës për kontrollin e kalimit të kufirit shtetëror, pa pagesë. Leja turistike është e vlefshme për 30 ditë.

Shtetasit nga **Bosnje-Hercegovina, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Republika e Kroacisë** mund të hyjnë dhe të qëndrojnë në Malin e Zi deri në 90 ditë. Ata mund të udhëtojnë nëpër Malin e Zi me dokumente të vlefshme udhëtimi.

Shtetasit e vendeve të tjera që nuk përmenden këtu duhet të marrin një vizë të vlefshme për të hyrë në Malin e Zi.

#### Llojet e vizave

##### **Viza tranzit aeroportuale (viza A)**

Një i huaj që nuk largohet nga zona tranzit e aeroportit apo nga avioni gjatë një ndalesë ndërmjetëse në aeroportet e Malit të Zi nuk ka nevojë për vizë. Në raste të veçanta, qeveria mund të vendosë se shtetas të huaj që kanë destinacione të caktuara, duhet të kenë vizë tranzit aeroportuale.

Kjo paketë informuese u përgatit në kuadër të projektit AENEAS 2006: Ndërtimi i Kapaciteteve, Informacion dhe Ndërgjegjësim për Promovimin e Migracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor të financuar nga Bashkimi Europian dhe të bashkë-financuar nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin, Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, Ministria Italiane e Punëve të Jashtme/Bashkëpunimi Italian për Zhvillim dhe Qeveria e Lihtenshtejn.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra



Federal Office  
for Migration  
and Refugees



GOVERNMENT  
OF LIECHTENSTEIN

### **Viza tranzit (viza B)**

Viza tranzit lëshohet për një, dy ose më shumë kalime në territorin e Malit të Zi me qëllimin për të mbërritur në destinacionin përfundimtar të një vendi të tretë. Viza tranzit është e vlefshme për një kohë deri në gjashtë muaj. Me një vizë tranzit, i huaji mund të qëndrojë në Malin e Zi për një kohë maksimale prej pesë ditësh.

### **Viza për qëndrim të shkurtër (viza C)**

Vizat për qëndrim të shkurtër lëshohen për një apo më shumë hyrje, për qëllime turizmi, tregtie, personale, apo të tjera. Kohëzgjatja e përgjithshme e qëndrimit të të huajit me vizë për qëndrim të shkurtër në Malin e Zi nuk mund të jetë më e gjatë se 90 ditë, gjashtë muaj pas hyrjes së parë. Viza për qëndrim të shkurtër me shumë hyrje është e vlefshme për një vit.

Viza për qëndrim të shkurtër nuk mund të zgjatet.

### **Viza për qëndrim të gjatë (viza D)**

Vizat për qëndrim të gjatë u lëshohen të huajve që kanë qëllim të qëndrojnë në Malin e Zi në mënyrë të vazhdueshme, deri në një vit nga dita e parë e vlefshmërisë së vizës.

## **3. Imigracioni për qëllime punësimi**

### **Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të punëtorëve të huaj**

Akti bazë që parashikon punësimin e të huajve në Malin e Zi është Ligji për Punësimin dhe Punën e të Huajve ("Fletorja Zyrtare e Malit të Zi", numër 11/04): <http://www.gom.cg.yu/files/1175075336.pdf>

Një i huaj mund të punësohet ose të lidhë një kontratë punë, nëse ai/ajo ka lejen e qëndrimit të përhershëm apo të përkohshëm në Malin e Zi dhe nëse ai/ajo merr leje pune.

Një i huaj, të cilit i lëshohet një leje pune, mund të punojë vetëm në pozicione për të cilat ai/ajo ka lidhur kontratë pune ose kontratë të posaçme, ose vetëm me punëdhënësin me të cilin ai/ajo ka lidhur kontratë mbi bazën e lejes së punës.

### **Leja e punës**

Leja e punës e lejon një punëdhënësi të lidhë një kontratë pune ose një kontratë të posaçme me një të huaj. Byroja e Punësimin të Malit të Zi është autoriteti përgjegjës për lëshimin e lejeve të punës për të huajt.

Kërkesa për lëshimin e lejes së punës duhet të dorëzohet nga:

1. I huaji që ka leje të qëndrimit të përhershëm në Malin e Zi;
2. Punëdhënësi i të huajit që ka lejen e qëndrimit të përkohshëm në Malin e Zi

Punëdhënësi duhet t'i bashkëngjisë dokumentet e mëposhtme kërkesës për lëshimin e lejes së punës:

- Dokumentin e udhëtimit të të huajit, prova të lejes së qëndrimit të përkohshëm, prova të diplomës së kualifikimit për një lloj të caktuar profesioni dhe prova të gjendjes së përgjithshme shëndetësore;
- Të dhëna për pozicionin e punës ose llojin e punës dhe kushtet e punës në lidhje me këtë pozicion;
- Prova të regjistrimit të organizatës përkatëse të biznesit, degës ose aktivitetit tregar në Republikën e Malit të Zi;
- Argumente për punësimin e një të huaji

### **Përjashtime nga leja e punës**

Të huajt që kanë lejen e qëndrimit të përkohshëm në Malin e Zi nuk kanë detyrimin për të marrë leje pune në rastet e mëposhtme:

- themelues, financiarë, pjesëtarë të organeve menaxhuese dhe drejtuese, si dhe revizorë të një organizate tregtare që kryejnë veprimtari në këtë organizatë tregtare, nëse kryerja e kësaj veprimtarie nuk ka natyrë punësimi dhe nuk zgjat më shumë se tre muaj në vit;
- stafi akademik që ftohet në cilësinë e profesorëve apo lektorëve dhe punonjësve shkencorë që marrin pjesë në një projekt shkencor kërkimi, të rëndësishëm për Malin e Zi;

- anëtarë të misioneve ndërkombëtare që kryejnë aktivitet kërkimor në Mal të Zi, që është i miratuar nga qeveria;
- korrespondentë të huaj të caktuar në Malin e Zi ose gazetarë të medias së huaj;
- artistë dhe staf teknik për operan, baletin, teatrin, koncertet, artet e bukura dhe veprimtaritë e tjera kulturore, nëse ata nuk qëndrojnë në Malin e Zi për një kohë më të gjatë se 30 ditë ose tre muaj në vit me ndërprerje;
- të huaj që vijnë në Malin e Zi për të marrë pjesë në evenimente sportive;
- të huaj që kryejnë veprimtari në lidhje me dorëzimin, instalimin apo shërbimin e makinerive ose pajisjeve, nëse puna e tyre nuk zgjat më shumë se 30 ditë pa ndërprerje, ose një kohë të përgjithshme prej tre muajsh në vit me ndërprerje;
- të huaj që marrin pjesë në panairë dhe ekspozita ku ekspozon punëdhënësi i tyre;
- të huaj që marrin pjesë në mbledhje dhe seminare profesionistësh;
- të huaj të punësuar në cirqe ose parqe argëtimi, nëse ata nuk qëndrojnë në Malin e Zi për një kohë më të gjatë se tre muaj pa ndërprerje.

### **Përgjegjësitë dhe kushtet**

Një leje pune për një të huaj nuk është më e vlefshme pas:

- përfundimit të periudhës së vlefshmërisë,
- përfundimit të kontratës së punës ose kontratës së posaçme,
- anulimit.

Byroja e Punësimit e anulon lejen e punës nëse:

- ajo është lëshuar mbi bazën e të dhënave të pasakta për të huajin ose punëdhënësin;
- punëdhënësi nuk e lidh kontratën e punës ose kontratën e posaçme me të huajin brenda afatit kohor;
- i huaji me leje pune, kryen veprimtari që lidhen me pozicionin për të cilin ai/ajo nuk ishte në gjendje të lidhte kontratën e punës ose kontratën e posaçme;
- të huajit i ka përfunduar leja e qëndrimit të përkohshëm ose leja e qëndrimit të përhershëm, në përputhje me ligjin.

Në rastin e ndërprerjes së kontratës së punës ose kontratës së posaçme, punëdhënësi ka detyrimin të njoftojë Byronë e Punësimit brenda 8 ditësh nga ndërprerja e saj.

### **Për sa kohë është e vlefshme një leje pune?**

Leja e punës mund të lëshohet për periudha të ndryshme kohore.

Megjithatë ajo nuk mund të lëshohet për një periudhë më të gjatë sesa vlefshmëria e lejes së qëndrimit të përkohshëm.

Për të zgjatur lejen e punës, punëdhënësi duhet të dorëzojë një kërkesë brenda 45 ditëve nga data e përfundimit të vlefshmërisë së lejes së punës.

### **Lidhja e kontratës së punës**

Punëdhënësi ka detyrimin që, përpara se të fillojë puna dhe brenda 15 ditëve nga lëshimi i lejes së punës, të lidhë me të huajin një kontratë pune ose kontratë të posaçme në përputhje me rregullat për punësimin.

### **Qëndrimi i përkohshëm për punësim**

Qëndrimi i përkohshëm për punësim, tregti apo veprimtari sipërmarrëse mund t'u jepet shtetasve të mëposhtëm:

- 1) të cilëve u është lëshuar një leje pune nga shërbimi publik për punësimin dhe
- 2) që synojnë të qëndrojnë në Malin e Zi për një kohë më të gjatë se 30 ditë, nëse ai/ajo i përmbush kushtet e tjera të parashikuara në ligj dhe nëse nuk ka nevojë për leje pune

Leja e qëndrimit të përkohshëm për shtetasit e huaj lëshohet për periudhën e përcaktuar në lejen e punës

### **Më shumë detaje për lejet e punës mund të gjeni:**

(Faqja elektronike e Agjencisë së Punësimit të Malit të Zi): [www.zzzcg.org](http://www.zzzcg.org).

(Faqja elektronike e ONP): [www.ilo.org](http://www.ilo.org)

## **Sektorët e tregut të punës që po përjetojnë mungesa**

Mungesat në tregun e punës janë shfaqur kryesisht në fusha për të cilat krahu i punës në Malin e Zi nuk shfaq interes. Punëdhënësit kanë nevojë të paplotësuara kryesisht në turizëm, shërbime ushqimi, bujqësi, ndërtim, tregti, industrinë prodhuese.

Edhe sektori publik/shtetëror karakterizohet nga mungesë e theksuar aftësish (aftësi teknike dhe drejtuese).

### **Kërkimi për punë**

#### ***Zavod za zapošljavanje Crne Gore (Agjencia e Punësimit të Malit të Zi)***

<http://www.zzcg.org>

#### ***Career Ways (Rrugët e Karrierës)***

Qëllimi i tyre kryesor është të reduktojnë papunësinë ndër të rinjtë me arsim të lartë në Malin e Zi.

Jovana Tomaševića 37, 81000 Podgorica

Tel: +381 69 626 426, +382 020/241-138 lok.139

<http://www.careerways.cg.yu>

**Shikoni gjithashtu:** [www.learn4good.com](http://www.learn4good.com)

### **Linqe të tjera:**

#### ***Nacionalna služba za zapošljavanje (Republika e Serbisë)***

<http://www.rztr.co.yu>

#### ***Hrvatski zavod za zapošljavanje (Republika e Kroacisë)***

<http://www.hzz.hr>

#### ***Federalni zavod za zapošljavanje Bosne i Hercegovine (Bosnje-Hercegovina)***

<http://www.fzzz.ba>

#### ***Zavod Republike Slovenije za zapošljavanje (Republika e Sllovenisë)***

<http://www.ess.gov.si>

#### ***Agencija za vrabotuvanje na Republika Makedonija (Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë)***

<http://www.zvrm.gov.mk>

### **Kuotat dhe marrëveshjet dypalëshe**

Qeveria e Malit të Zi, në përputhje me politikat e saj të migracionit, kushtet dhe lëvizjet në tregun e punës, përcakton çdo vit numrin e lejeve të punës për të huajt.

Punët sezonale ku vërehen mungesa janë në fushën e turizmit, menaxhimit të hoteleve dhe restoranteve, si dhe ndërtimit.

Brenda kuotës, përcaktohen veprimtaritë dhe profesionet ku mund të punësohen të huajt, numri i lejeve të punës për çdo veprimtari dhe profesion, si dhe shpërndarja territoriale e lejeve të punës.

Në lidhje me marrëveshjet dypalëshe, ka një rregullore për përfshirjen e personave që nuk qëndrojnë në Malin e Zi, e cila përcakton mënyrën e punësimit të të huajve (2003). Punëdhënësit janë të detyruar të paraqesin kërkesë pranë Agjencisë së Punësimit për të lëshuar lejen për punësimin e personit që nuk qëndron në Malin e Zi (person që nuk banon në territorin e Malit të Zi). Brenda 24 orëve, Agjencia e Punësimit ka për detyrë të lëshojë lejen. Punëdhënësi duhet të paguajë 2.5 Euro për çdo ditë pune të personit që nuk qëndron në Malin e Zi. Nëse personi merret me bujqësi, taksa është më pak për 50%.

Gjithashtu, punëdhënësi duhet të nënshkruajë një kontratë me punonjësin dhe të paguajë taksën për të ardhurat në përputhje me Ligjin për Taksat, si dhe të paguajë sigurimin në rast dëmtimi apo sëmundjeje profesionale.

Kuota nuk përfshin lejet e punës që lëshohen për:

- të huajt që kanë filluar një punë për periudhë të pacaktuar, në bazë të kushteve të reciprocitetit ose të një marrëveshjeje ndërkombëtare;
- të huajt që kryejnë veprimtari në një organizatë tregtare ose degë të saj, me të cilën është lidhur një kontratë bashkëpunimi teknik;
- stafin arsimor, mësimor dhe akademik që merret me mësimdhënien në institucionet arsimore, në gjuhën dhe alfabetin e një grupi kombëtar dhe etnik;
- sportistët profesionistë apo punonjësit e sportit që punojnë në Malin e Zi mbi bazën e një kontrate;
- bashkëshortin/en dhe fëmijët e të huajve të cilëve u është miratuar qëndrimi i përhershëm në Republikën e Malit të Zi

## 4. Imigracioni për qëllime studimi

Arsimi në Malin e Zi rregullohet nga Ministria Malazeze e Arsimit dhe Shkencës.

Arsimi fillon në institucionet parashkollore ose shkollat fillore. Fëmijët regjistrohen në shkollat fillore (në Malin e Zi: Osnovna škola) në moshën 6 vjeç; dhe kjo zgjat 9 vjet. Studentët mund të vijojnë arsimin e mesëm, i cili zgjat 4 vjet (3 vjet për shkollat tregtare) dhe përfundon me diplomimin (Matura). Arsimi i lartë zgjat me një diplomë të parë pas 3 deri në 6 vjetësh.

### Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit për studentët

Studentët e huaj duhet të aplikojnë për qëndrim të përkohshëm për shkollim dhe arsimim.

Me kërkesën për lejen e qëndrimit të përkohshëm për studim, shkollim, specializim ose kualifikim, një shtetas i huaj duhet të paraqesë, përveç provave të sipërpërmendura për të përmbushur kriteret e Ligjit për të Huajt, vërtetimin për studimin ose shkollimin.

Leja e qëndrimit të përhershëm mund të zgjatet për një kohë maksimale prej dy vjetësh pas përfundimit të afatit të caktuar për shkollim, studim, specializim ose kualifikim.

### Shoqatat e studentëve

#### Shoqata e Studentëve të Malit të Zi

Duke u bërë anëtar i kësaj Shoqate, çdo student përfiton të drejtën për të marrë pjesë aktivisht në projektet e Shoqatës, si dhe të drejtat për përfitimet e kartës së studentit. Projekti i Kartës së Studentit i siguron përfitime të reja studentëve anëtarë të Shoqatës së Studentëve të Malit të Zi dhe aktualisht përfshin bashkitë e Podgoricës dhe Nikshiçit, me planin për t'u zgjeruar në të gjitha bashkitë e Malit të Zi. Ata që përdorin kartat e studentit përfitojnë ulje të konsiderueshme për mallrat dhe shërbimet.

Faqja elektronike: [www.sscg.cg.yu](http://www.sscg.cg.yu)

#### SESD

Emri i plotë është Shoqata Evropiane e Studentëve të Drejtësisë. SESD ka mbi 160 anëtarë. Është një organizatë e studentëve të drejtësisë. SESD e Malit të Zi është anëtare e SESD të Jugosllavisë dhe nëpërmjet saj, anëtare e SESD Ndërkombëtare, dmth. Shoqata Evropiane e Studentëve të Drejtësisë që ka 42 vende anëtare në Evropë.

Në organizatën e saj, SESD e Malit të Zi ka disa sektorë:

- 1) Sektori i Veprimtarive Akademike,
- 2) Sektori i Seminareve dhe Konferencave,
- 3) Sektori i Marketingut,
- 4) Sektori PSTS (Programi i Shkëmbimit të Trainimit të Studentëve).

Çdo student i Fakultetit të Drejtësisë që dëshiron të marrë pjesë në SESD bëhet anëtar i saj duke nënshkruar një formular anëtarësimi. Kushti për t'u bërë anëtar është njohja e një gjuhe të huaj dhe kryerja e një trainimi për të përfituar njohuritë e nevojshme për SESD dhe funksionimin e saj.

Faqja elektronike: [www.elsa.cg.yu](http://www.elsa.cg.yu)

## **Bursat universitare dhe pasuniversitare**

Studimet pasuniversitare

Studimet e specializuara zgjasin një vit akademik, dmth. dy semestra.

Studimet pasuniversitare zgjasin dy (1+1) vite akademikë, dmth. katër semestra.

Personat që kanë përfunduar studimet universitare kanë të drejtën për t'u regjistruar në studimet pasuniversitare. Studentët kanë të drejtën të japin tezën e masterit pasi të kenë kaluar të gjitha provimet e programit mësimor të shkollimit pasuniversitar. Pasi kanë mbrojtur tezën e tyre të masterit në publik, studenti përfiton titullin akademik të masterit në shkenca ose masterit në arte në një fushë të caktuar.

Diploma e doktoraturës

Studimet e doktoraturës në Universitetin e Malit të Zi zgjasin tre vite akademikë, dmth. tre semestra.

Një person që ka titullin akademik master në shkenca ose master në arte, mund të regjistrohet për studime doktorature. Procedura për të siguruar temën e një disertacioni doktorature dhe për të zgjedhur një udhëheqës dhe komitetin për vlerësimin dhe mbrojtjen e disertacionit të doktoraturës, kërkon një miratim të detyrueshëm nga Senati i Universitetit. Studentët kanë të drejtën të mbrojnë tezën e tyre të doktoraturës pasi të kenë kaluar të gjitha provimet e programit të studimeve të doktoraturës. Pasi ka mbrojtur tezën e doktoraturës në publik, studenti merr titullin akademik (Ph.D).

## **Linqe të rëndësishme:**

Universiteti i Malit të Zi (<http://www.ucg.cg.ac.yu>)

Zavod za školstvo (<http://www.zavodzaskolstvo.org/cg/linkovi/>)

Centar za stručno obrazovanje / Qendra për Arsimin dhe Trainimin Profesional (<http://www.cso.cg.yu>)

Zavod za udžbenike i nastavna sredstva (<http://www.cgudzbenici.cg.yu>)

## **Universitetet dhe kolegjet kryesore**

Ka dy lloje institucionesh të arsimit të lartë në Malin e Zi:

- 1) Universiteti i Malit të Zi – universitet publik
- 2) Universiteti Mesdhetar – universitet privat

### Universiteti i Malit të Zi

I themeluar më 29 prill 1974, ai zhvillon aktivitetin në frymën e kohës dhe nevojave të Malit të Zi. Universiteti është zgjeruar mjaft vitet e fundit. Universiteti i Malit të Zi është i vendosur në 5 qytete: Podgoricë, Nikshic, Cetinje, Kotor dhe Herceg Novi.

Programet e studimit në Universitetin e Malit të Zi janë si më poshtë:

- Studimet në shkollat e mesme, BAP (3 vjet)
- Studime akademike universitare, BS, BA (3 vjet)
- Studime Master MS, MA (BS, BA + 2 vjet)
- Studime Doktorature (MS, MA + 3 vjet)

Universiteti përfshin 14 fakultete dhe një kolegji:

- Fakulteti i Ekonomisë  
Jovana Tomaševića 37, 81000 Podgorica  
+382 020 241 138

<http://www.ekonomija.cg.yu>

- Fakulteti i Drejtësisë, Podgoricë
- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, Podgoricë
- Fakulteti i Metalurgjisë dhe Teknologjisë, Podgoricë
- Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Podgoricë
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Podgoricë
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Matematikës, Podgoricë
- Fakulteti i Mjekësisë, Podgoricë
- Fakulteti i Filozofisë, Niksic
- Akademia e Arteve të Bukura, Cetinje
- Fakulteti i Dramës, Cetinje
- Fakulteti i Muzikës, Podgoricë
- Fakulteti i Studimeve Detare, Kotor  
Dobrota 36, 85330 Kotor  
+382 032/25-600, 13-141  
<http://faculty.kotor.com>
- Fakulteti i Turizmit dhe Menaxhimit të Hotelierisë, Kotor
- Kolegji i Fizioterapisë, Herceg Novi

Universiteti përfshin edhe katër institute të kërkimit shkencor:

- Institutin e Gjuhëve të Huaja,
- Institutin e Bioteknologjisë,
- Institutin e Historisë,
- Institutin e Biologjisë Detare.

Brenda Universitetit janë edhe Qendrat e mëposhtme:

- Qendra e Teknologjisë së Informacionit dhe
- Qendra e të Drejtave të Njeriut
- Qendra për Studimet Ndërkombëtare,
- Qendra për Cilësinë në Universitet

Në bazë të nevojave, fakultetet organizojnë edhe programe të ndryshme për trainim dhe zhvillim profesional.

### Studimet universitare

Studimet universitare, në pjesën më të madhe të fakulteteve të Universiteti të Malit të Zi, zgjasin tre vjet. Kandidatët që kanë përfunduar arsimin e përshtatshëm katër-vjeçar, mund të regjistrohen në vitin e parë të studimeve. Tarifat e shkollimit mund të paguhet nga buxheti ose nga vetë studenti. Qeveria e Malit të Zi përcakton numrin e studentëve që do të regjistrohen në vitin e parë, si dhe tarifën e shkollimit për studentët me vetë-financim.

Përzgjedhja e kandidatëve për t'u regjistruar në vitin e parë të studimeve bazohet në dy kritere së bashku:

- rezultatet e shkollës së mesme (provimet e maturës)
- rezultatet e provimit të pranimit (për fakultetet e arteve).

Regjistrimi në vitin e parë të studimeve organizohet në fund të qershorit, në korrik dhe në fund të gushtit.

Mësimdhënia kryhet nëpërmjet leksioneve, ushtrimeve, seminareve, konsultimeve, punës praktike, trainimit profesional dhe formave të tjera të mësimdhënies. Gjatë studimeve, arritjet e studentëve vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet: kolokiumeve, eseve dhe së fundi, provimeve.

Vizitoni faqen elektronike të Universitetit të Malit të Zi: <http://www.ucg.cg.ac.yu>

### Universiteti Mesdhetar

Universiteti Mesdhetar është universiteti i parë privat në Malin e Zi dhe një institucion plotësisht i akredituar që jep diploma universitare dhe Master në turizëm dhe menaxhim hotelierie, drejtësi dhe gjuhë të huaja. Programet e tyre tërheqin studentët e motivuar të cilët dëshirojnë të përdorin njohuritë moderne dhe të zhvillojnë mundësitë për karrierë me aftësitë që sigurojnë diplomat universitare dhe ato Master (MBA).

Ky universitet ofron programet e mëposhtme të diplomave:

- 1) Diplomë universitare për turizëm, menaxhim hotelerie dhe tregti;
- 2) Administrim biznesi (programe në financë dhe marketing);
- 3) Teknologji informacioni;
- 4) Arte vizive;
- 5) Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (hapur për vitin e ardhshëm akademik).

### **Programet për studentët e huaj, aty ku gjejnë zbatim**

Universiteti i Malit të Zi bashkëpunon me një sërë institucionesh shkencore dhe arsimore në vend dhe jashtë. Bashkëpunimi me institucionet e huaja realizohet nëpërmjet anëtarësimit në mjaft shoqata dhe rrjete ndërkombëtare universitare, si dhe nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe.

Universiteti i Malit të Zi ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitetet e mëposhtme: Universitetin e Barit, Universitetin La Sapienza në Romë, Universitetin e Foxhjas, Universitetin e Varshavës në Poloni, Universitetin Shtetëror të Moskës në Rusi, Universitetin e Shkodrës në Shqipëri, Universitetin e Bremenit në Gjermani, Universitetin e Oslos në Norvegji, Universitetin e Bergenit në Norvegji, Universitetin e Turit në Francë, Universitetin e Bratislavës në Republikën Sllovaqe, Universitetin e Grandaës në Spanjë dhe Universitetin Charles Sturt në Australi.

Bashkëpunimi me **Serbinë** dhe me **Maqedoninë** përfshin edhe **shkëmbimin e studentëve**. Për më shumë informacion, mund të kontaktoni me Universitetet përkatëse:

#### Në Serbi

Departamenti për bashkëpunimin universitar ndërkombëtar dhe kombëtar  
Zëvendësrektor për marrëdhëniet ndërkombëtare: Prof.dr Aleksandar Sedmak  
Drejtor i departamentit: Branka Janda-Markovic  
Adresa: Studentski trg 1, Beograd  
Tel: (+381 11) 3207 445, 3207 452  
e-mail: [officebu@rect.bg.ac.yu](mailto:officebu@rect.bg.ac.yu)  
Faqja elektronike: [www.bg.ac.yu](http://www.bg.ac.yu)

#### Në Maqedoni

Zyra e Marrëdhënieve me Publikun, Kaliopa Krivašija-Stilinovic  
tel: 047-223 192  
e-mail: [kaliopa.stilinovic@uklo.edu.mk](mailto:kaliopa.stilinovic@uklo.edu.mk)

Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Cvetanka Šundovska  
tel: 047-223 788  
e-mail: [cvetanka.shundovska@uklo.edu.mk](mailto:cvetanka.shundovska@uklo.edu.mk)  
Bul.1-vi Maj b.b. p.fax.100  
7000 Bitola  
Tel: 047-223788 ; 047-223192  
e-mail: [rektorat@uklo.edu.mk](mailto:rektorat@uklo.edu.mk)

Që nga viti 2002 janë realizuar një numër projektsh në Universitetin e Malit të Zi me programet e Bashkimit Evropian: TEMPUS, SOCRATES, ERASMUS - MUNDUS. Universiteti i Malit të Zi bashkëpunon me UNESCO-n, Këshillin e Evropës, Këshillat Amerikanë, WUS-Austria, Këshillin Britanik, etj.

**Për më shumë informacion**, mund të shihni: <http://www.ir.cg.ac.yu/engleski/evropa.html>

### **IAESTE**

Mali i Zi është anëtare e rrjetit IAESTE – Organizatës Ndërkombëtare për Shkëmbimin e Studentëve në fushën e inxhinierisë dhe shkencave të natyrës për kryerjen e praktikës profesionale. IAESTE u themelua në vitin 1948 në Kolegjin Imperial në Londër dhe sot rreth 90 vende nga e gjithë bota marrin pjesë në këtë shkëmbim.

Që nga momenti i themelimit e deri sot, mbi 850 000 studentë kanë marrë pjesë në programet e shkëmbimit.

Synimet kryesore të IAESTE janë:

- të njihen studentët me industrinë, shkencën dhe teknikën e vendeve të tjera;
- të mundësohet përmirësimi i njohurive të gjuhëve të huaja nëpërmjet qëndrimit jashtë vendit;
- t'u krijohet mundësia studentëve të zhvillojnë praktikën profesionale në shoqëritë përkatëse.

Vitin e kaluar u realizuan **12 vizita studimore profesionale të studentëve malazezë**, kryesisht në vendet e Evropës Perëndimore. Në të njëjtën kohë, **26 studentë të huaj zhvilluan praktikën e tyre profesionale në Malin e Zi**.

Faqja elektronike: <http://www.iaeste.org/network/montenegro.html>

## 5. Qëndrimi

### Llojet e qëndrimit për shtetasit e huaj

- 1) Qëndrimi deri në 90 ditë
- 2) Qëndrimi i përkohshëm (deri në dy vjet)
- 3) Vendosja e përhershme

Qëndrimi deri në 90 ditë konsiderohet qëndrimi i shtetasve të huaj pa vizë, me vizë ose me leje kalimi kufitar, me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe me ligj ose në kontratat ndërkombëtare.

### Qëndrimi i përkohshëm

Qëndrimi i përkohshëm i sigurohet një shtetasi të huaj që ka vizë dhe synon të qëndrojë për një kohë më të gjatë se 90 ditë për arsye të ndryshme nga ato për të cilat i është dhënë viza.

#### Procedura dhe kriteret

Kërkesa për lejen e parë të qëndrimit të përkohshëm duhet të paraqitet pranë zyrave diplomatike ose konsullore jashtë vendit. Me kërkesën për të lëshuar lejen, shtetasi i huaj është i detyruar të dorëzojë një pasaportë të vlefshme, si dhe prova të tjera që justifikojnë arsyet për të cilat ai/ajo kërkon miratimin e qëndrimit të përkohshëm.

Një shtetas i huaj që nuk ka nevojë për vizë për të hyrë në Malin e Zi, mund të dorëzojë kërkesën e tij/saj për lejen e parë të qëndrimit të përkohshëm pranë organit kompetent, Ministrisë së Brendshme.

Kërkesat për zgjatje të lejes së qëndrimit të përkohshëm duhet t'i drejtohen organit kompetent brenda 30 ditëve nga përfundimi i vlefshmërisë së lejes së qëndrimit të përkohshëm.

Leja e qëndrimit të përkohshëm mund të zgjatet për një kohë maksimale prej dy vjetësh, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj.

Leja e qëndrimit të përkohshëm vendoset në pasaportën e shtetasit të huaj. Pasaporta duhet të jetë e vlefshme për të paktën tre muaj pas datës për të cilën lëshohet leja.

Leja e qëndrimit të përkohshëm i lëshohet një shtetasi të huaj që synon të qëndrojë në Malin e Zi për **arsyet** e mëposhtme:

- punësim, tregti apo aktivitet sipërmarrës;
- studim dhe shkollim, specializim ose kualifikim, pjesëmarrje në programe ndërkombëtare të shkëmbimit të studentëve ose programe të tjera për të rinjtë;
- punë sezonale;
- bashkim familjar dhe
- arsye të tjera të justifikuara, siç përcaktohen me ligj ose me kontratat ndërkombëtare.

Një shtetas i huaj që ka përfituar lejen e qëndrimit të përkohshëm për arsyet e mësipërme, mund të qëndrojë në Malin e Zi për kohën e përcaktuar në lejen e tij/saj.

#### Kushtet për lëshimin e lejes

Leja e qëndrimit të përkohshëm mund të miratohet për shtetasin e huaj nëse:

- ai/ajo disponon fondet e nevojshme për shpenzimet;
- ai/ajo ka sigurim shëndetësor;
- nuk ka pengesa ligjore dhe
- ai/ajo ka siguruar prova që justifikojnë kërkesën për leje qëndrimi të përkohshëm.

Me kërkesën për lejen e parë të qëndrimit të përkohshëm, shtetasi i huaj ka detyrimin për të paraqitur dëshminë e penalitetit.

**Leje e qëndrimit të përkohshëm për studim (ju lutemi të shihni seksionin 4 më sipër)**

**Leje e qëndrimit të përkohshëm për punësim (ju lutemi të shihni seksionin 3 më sipër)**

**Leje e qëndrimit të përkohshëm për bashkim familjar (ju lutemi të shihni seksionin 7 më poshtë)**

#### **Vendosja e përhershme**

Leja e vendosjes së përhershme mund të miratohet për:

- një të huaj që, deri në momentin e dorëzimit të kërkesës për vendosje të përhershme, ka qëndruar për pesë vjet të pandërprerë mbi bazën e lejes së qëndrimit të përkohshëm;
- një të huaj që ka të paktën tre vjet martesë me një shtetas malazez ose të huaj që ka leje për vendosje të përhershme dhe që i është miratuar leja e qëndrimit të përkohshëm;
- një të huaj – të mitur me qëndrim të përkohshëm në Malin e Zi, nëse njëri prej prindërve është i huaj që ka marrë lejen për vendosje të përhershme, pasi është marrë miratimi i prindit tjetër;
- një të huaj me origjinë malazeze;
- një të huaj që është pjesëtar i afërt i familjes së një shtetasi malazez ose një të huaji që ka leje vendosjeje të përhershme në Malin e Zi ose që ka statusin e refugjatit.

Vendosja e përhershme shënohet në dokumentin e udhëtimit të të huajit.

**Ligji për Regjistrat e Banorëve me Qëndrim të Përkohshëm dhe të Përhershëm:**

<http://www.gom.cg.yu/files/1207921717.doc>

## **6. Sistemi i azilit**

### **Ligji për Azilin**

Ligji parashikon parimet, kushtet dhe procedurat për dhënien e azilit, njohjen e statusit të refugjatit dhe akordimin e mbrojtjes plotësuese dhe të përkohshme, autoritetet përgjegjëse për vendimmarrjen, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, personat të cilëve u është dhënë statusi i refugjatit dhe personat të cilëve u është akorduar mbrojtja plotësuese ose e përkohshme, si dhe arsyet për ndërprerjen dhe revokimin e statusit të refugjatit dhe mbrojtjes plotësuese dhe ndërprerjes së mbrojtjes së përkohshme në Malin e Zi.

### **Miratimi i kërkesës për azil**

Një i huaj ka të drejtë të bëjë kërkesë për azil në Malin e Zi. Azili miratohet për të huajt që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare në përputhje me Koventën në lidhje me Statusin e Refugjatit të vitit 1951, Protokollin në lidhje me Statusin e Refugjatit të vitit 1967, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të vitit 1950, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe rregullat e pranuar gjerësisht të së drejtës ndërkombëtare, në bazë të këtij legjislacioni.

Statusi i refugjatit i njihet një të huaji nëse, mbi bazën e kërkesës së tij/saj për azil, është vendosur se ai/ajo ka një frikë të bazuar nga persekutimi për arsye të racës, fesë, nënshtrësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror, ose mendimit politik, në vendin e tij/saj të origjinës dhe për shkak të kësaj frike ai/ajo nuk mundet ose nuk dëshiron të kërkojë mbrojtje në vendin e origjinës.

Mbrojtja plotësuese, si mbrojtje shtesë për refugjatët në përputhje me instrumentat për të drejtat e njeriut, i akordohet një të huaji që nuk ka plotësuar kriteret për njohjen e statusit të refugjatit, por që do t'i nënshtrohej torturës ose trajtimit apo ndëshkrimit çnjerëzor dhe degradues, apo jeta, siguria ose liria e të cilit rrezikohet nga dhuna e përgjithshme, agresioni i huaj, konflikti i brendshëm, shkeljet në masë të të drejtave të njeriut ose rrethana të tjera të cilat kërcënojnë seriozisht jetën, sigurinë apo lirinë, në rast se ai/ajo kthehet në vendin e origjinës ose në një shtet tjetër.

Mbrojtja e përkohshme është një masë urgjente dhe e jashtëzakonshme me anë të së cilës të huajt sigurojnë mbrojtje në rastin e një fluksi në masë, të papritur ose të pritshëm nga një shtet ku jeta, siguria ose liria e tyre rrezikohet nga dhuna e përgjithshme, agresioni i huaj, konflikti i brendshëm, shkeljet në masë të të drejtave të njeriut ose rrethana të tjera të cilat kërcënojnë seriozisht jetën, sigurinë apo lirinë, ku për shkak të fluksit në masë nuk ka asnjë mundësi për të kryer procedura individuale për përcaktimin e statusit të refugjatit.

### **Autoritetet që kanë përgjegjësi për vendimin dhe kujdesin**

Zyra për Azilit në Ministrinë e Brendshme kryen procedurën në nivelin e parë, pranon kërkesat dhe merr vendimet për kërkesat, kryen procedurën dhe merr vendimin për ndërprerjen dhe revokimin e azilit, si dhe kryen detyra të tjera.

Vendimi për kërkesën për azil merret brenda tre muajve nga dita e dorëzimit të aplikimit, me përjashtim të rasteve kur në Ligjin për Azilim parashikohet një periudhë më e shkurtër.

**Më shumë informacion**, mund të gjeni tek: [www.vlada.cg.yu/eng/minunutr](http://www.vlada.cg.yu/eng/minunutr)

## **7. Bashkimi familjar**

### **Qëndrimi i përkohshëm për bashkim familjar**

Kërkesa për miratimin e qëndrimit të përkohshëm për bashkim familjar duhet të paraqitet nga një shtetas i huaj që është i afërm (më saktësisht burri/gruaja, fëmijët e lindur nga martesë apo jashtë martesë, fëmijët e birësuar apo thjeshtit) e një shtetasi malazez ose e një shtetësi të huaj me qëndrim të përhershëm ose të përkohshëm, ose me statusin e refugjatit në Malin e Zi.

Në raste të veçanta, 'të afërmit' mund të përfshijnë edhe të afërm të tjerë që nuk janë renditur më sipër – nëse ka arsye të veçanta, personale apo humanitare që i huaji të bashkohet me pjesëtarin e familjes në Malin e Zi.

Shikoni Seksionin 5 më sipër për qëndrimin e përkohshëm për të gjetur më shumë hollësi në lidhje me kushtet dhe procedurat.

## **8. Sistemi i kujdesit shëndetësor**

### **Ligji për mbrojtjen shëndetësore për të huajt**

Ligji i mësipërm parashikon mbrojtjen shëndetësore për të huajt. Sipas këtij ligji, të huajt kanë detyrimin për të paguar shpenzimet e tyre dhe nëse vendi i tyre ka nënshkruar një marrëveshje me Malin e Zi, ata mund të rimbursohen për këto shpenzime në vendin e tyre. Kujdesi shëndetësor parësor është pa pagesë.

Më shumë informacion mund të gjeni në [www.vlada.cg.yu](http://www.vlada.cg.yu)

## 9. Sistemi i sigurimit shoqëror

Në Malin e Zi nuk ekziston një sistem sigurimi shoqëror për të huajt, pasi Mali i Zi është ende një shtet i ri, pra ka mjaft për të bërë për ndryshimet ligjore në lidhje me këtë çështje.

Por të huajt e punësuar në Malin e Zi (shikon seksionin 3, tema: Kuotat dhe marrëveshjet dypalëshe, si dhe seksionin 8) kanë të njëjtat të drejta për sigurimin shoqëror si çdo shtetas i punësuar i Malit të Zi.

Megjithatë, nuk përfshihet ndihma materiale nëse ai/ajo mbetet pa punë ose jeton në kushte të këqija jetese.

## 10. Strehimi

Çmimet e qirave mund të variojnë nga rreth 200 Euro në muaj për një apartament të vogël pa mobilje, deri në 800 Euro në muaj dhe më shumë për një apartament të madh e luksoz.

Mund të gjeni njoftime për dhënie me qira në të gjitha gazetat e përditshme (DAN, VIJESTI, POBJEDA) ose tek 'Tender' (revistë me lloj-lloj njoftimesh).

### Kontakte të nevojshme:

#### AS Nekretnine

Ulica Slobode 60, Podgorica

Tel: 020 230 057

E-mail: [asnekretnine@cg.yu](mailto:asnekretnine@cg.yu)

#### Krstas nekretnine

Ulica Kralja Nikole 33A, Podgorica

Tel: 020 066

[www.krstasnekretnine.com](http://www.krstasnekretnine.com)

#### In nekretnine

Cetinjski put bb, Podgorica

Tel: 020 235 641

[www.inekretnine.net](http://www.inekretnine.net)

## 11. Njohja e diplomave

Për njohjen e diplomave ju duhet të plotësoni një kërkesë zyrtare dhe të paguani një tarifë prej 150 Euro.

Nëse arsimi që keni marrë nuk është i njëjtë me atë të Malit të Zi, duhet të kaloni edhe provime të tjera për të ekuivalentuar diplomën tuaj.

Procedura zgjat rreth një javë.

Për më shumë informacion, duhet të kontaktoni me: **Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës** (Rimski trg bb, Podgorica ose tel. +382 20 405 301)

## 12. Shërbimet mbështetëse për migrantët

### Zyra për Migracionin

Në Ministrinë e Brendshme sapo është krijuar një Zyrë për Migracionin, e cila ofron informacion për migracionin, vizat dhe ripranimet, por nuk ekziston ende një institucion qeveritar për migrantët. Më shumë hollësi mund të gjeni në [mup.kabinet@cg.yu](mailto:mup.kabinet@cg.yu)

### Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (ONM)

Nëse viktimat e trafikimit janë shtetas të huaj, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (ONM) kujdeset për kthimin e tyre në vendin e origjinës nëse ata e zgjedhin këtë mundësi në mënyrë vullnetare dhe kontakton me zyrën përkatëse të ONM në atë vend ose me partnerë të tjerë lokalë të cilët mund ta ndihmojnë të kthyerin për strehim, punësim apo vazhdim të shkollimit.

ONM gjithashtu merret me të gjitha aspektet e migracionit. Më shumë hollësi mund të siguroni pranë zyrës së ONM (Dzordza Vashingtona III/ 45, Podgorica) me telefon: **020 234 332**, ose me e-mail: [m.s.c@cg.yu](mailto:m.s.c@cg.yu)

Në Malin e Zi ka gjithashtu një OJF e cila ofron ndihmë të drejtpërdrejtë për migrantët dhe të huajt, përveç **Lobimit të Grave Malazeze** dhe **Centre Plus** të cilat mbështesin viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

### **Trafikimi i qenieve njerëzore**

Qeveria e Malit të Zi ka një Program Kombëtar të gjerë i cili mbron viktimat e trafikimit dhe lufton fenomenin. Programi ofron një mjedis të sigurt kur viktimat të mund të rehabilitohen, **Strehezën për Viktimat e Trafikimit** që drejtohet nga **Lobimi i Grave Malazeze** (hollësitë për kontaktet mund t'i gjeni në seksionin 14 më poshtë) ku ofrohen mbështetja e nevojshme si dhe ndihme ligjore dhe psikologjike. Nëse keni nevojë për më shumë informacion, duhet të telefononi në **numrin pa pagesë (020 656 166)**

Ka gjithashtu edhe një **Strehëz të Përkohshme për Viktimat e Trafikimit** në Podgoricë, të drejtuar nga OJF-ja **Centre Plus** (hollësitë për kontaktet mund t'i gjeni në seksionin 14 më poshtë) me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (ONM). Nëse keni nevojë për më shumë informacion, duhet të telefononi në **numrin pa pagesë 24 orë (068 355 155)**

**Kurset e gjuhës angleze (& gjuhëve të tjera) dhe të asaj malazeze për të huajt:**

Qendra Oxford (në Podgoricë, Bar, Budva, Bijelo Polje, Cetinje dhe Niksic)

Tel: 020 234 425

[www.eaquals.org](http://www.eaquals.org)

Centar za obrazovanje i trening (Podgorica)

Miljana Vukova br. 9.

Tel: 020 231 660

E-mail : [cot.cg.yu](mailto:cot.cg.yu)

Qendra Educo

Kralja Nikole 29, Podgorica

Tel: 020 625 734

[www.educocentar.org](http://www.educocentar.org)

## **13. Marrja e nënshtetësisë**

Në bazë të ligjit, nënshtetësia malazeze mund të merret nëpërmjet origjinës, nëpërmjet lindjes në territorin malazez ose nëpërmjet pranimit në përputhje me kontratat dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Nënshtetësia malazeze mund të merret në bazë të kontratave ndërkombëtare të ratifikuara ose marrëveshjeve të nënshkruara nga Mali i Zi. Në bazë të kushteve të reciprocitetit, nënshtetësia e dyfishtë mund të përcaktohet nga kontratat dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Nënshtetësia malazeze mund të humbet duke hequr dorë ose me detyrim në bazë të kontratave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. Një shtetas malazez në moshë madhore, i cili ka edhe nënshtetësinë e një vendi tjetër, e humbet nënshtetësinë malazeze ligjërisht nëse ai/ajo merr nënshtetësinë e një vendi tjetër me miratimin e tij/saj, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

Një person që ka humbur nënshtetësinë malazeze dhe ka marrë nënshtetësinë e një vendi tjetër, mund të ri-marrë nënshtetësinë malazeze nëse ai/ajo paraqet një kërkesë zyrtare për të ri-marrë nënshtetësinë malazeze dhe nëse ai/ajo është vendosur në mënyrë të qëndrueshme në Malin e Zi të paktën një vit nga dita që ka humbur shtetësinë malazeze.

## **14. Informacion për kontakte të tjera të nevojshme**

### **Misionet diplomatike/konsullore**

#### Ambasada e Republikës së Shqipërisë

Stari Aerodrom, Zmaj Jovina 30, 81 000 Podgorica

Tel: +382 20 652 796; 652 837; 652 784

Fax: +382 20 652 798;

#### Ambasada e Republikës së Kroacisë

Vladimira Četkovića 2, Podgorica

Tel: + 382 20 269 760

Fax: + 382 20 269 810;

#### Ambasada e Republikës së Maqedonisë

Hercegovačka 49/III, Podgorica

Tel: + 382 20 667 415; 667-416

Fax: + 382 20 667-205

e-mail: [mkgkpodgorica@cg.yu](mailto:mkgkpodgorica@cg.yu);

#### Ambasada e Republikës së Serbisë

Adresa e përkohshme: Hotel "Podgorica", Bulevar Svetog Petra Cetinjskog 1, Podgorica

Tel: +382 20 402 525,

Fax: +382 20 402 567;

#### Ambasada e Bosnje-Hercegovinës

Atinska 58, Podgorica

Tel: +382 20 618 105; 618 015; 618 135; 618 156

Fax: +382 20 618 016;

### **Ministritë përkatëse**

#### Ministria e Punëve të Jashtme

Stanka Dragojevića 2, Podgorica

Tel: +382 20 242 299;

[www.vlada.cg.yu](http://www.vlada.cg.yu)

#### Ministria e Brendshme dhe Administratës Publike

Bulevar Svetog Petra Cetinjskog 22

Tel: 020/241-252; 020/242-483; 069 349 000; 067 449 000

E-mail: [mup.kabinet@cg.yu](mailto:mup.kabinet@cg.yu);

#### Ministria e Drejtësisë

Vuka Karadzica 3, Podgorica

Tel: 020/231-552

Fax: 020/407-515

E-mail: [minpravde@cg.yu](mailto:minpravde@cg.yu)

#### Ministria e Shëndetësisë, Punës dhe Përkrahjes Sociale

Rimski trg 46, Podgorica

Tel: +382 20 482-148

Fax: +382 20 234-227

[www.vlada.cg.yu](http://www.vlada.cg.yu)

#### Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Rimski trg bb, Podgorica

Tel: +382 20 405 301  
Fax: +382 20 405 334  
E-mail: [mpin@cg.yu](mailto:mpin@cg.yu)

Ministria për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave  
Rimski trg 46, Podgorica  
Tel: 020/482-126  
Fax: 020/234-198  
E-mail: [min.manj@cg.yu](mailto:min.manj@cg.yu)

### **Organizatat Ndërkombëtare**

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (ONM)  
Dzordza Vasingtona III/45, Podgorica  
Tel: + 382 20 234 332  
Fax: + 382 20 234 334

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (KLBKR)  
Nikca od Rovina 51, Podgorica  
Tel: + 382 20 238 066  
Fax: + 382 20 238 068

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF)  
Vladike Danila 28, Podgorica  
Tel: + 382 20 224 277  
Fax: + 382 20 224 278  
Faqja elektronike: [www.unicef.org/montenegro](http://www.unicef.org/montenegro)  
e-mail: [podgorica@unicef.org](mailto:podgorica@unicef.org)

Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)  
Bulevar Svetog Petra Cetinjskog 147, Podgorica  
Tel: + 382 20 406 401  
Fax: + 382 20 406 431  
e-mail: [omim@osce.org](mailto:omim@osce.org)

Delegacioni i Komisionit Evropian në Malin e Zi  
Hotel "Podgorica"  
Bulevar Svetog Petra Cetinjskog 1, Podgorica  
Tel: +382 20 402 525  
Fax: +382 20 655 567

Agjencia Evropiane për Rindërtim  
Atinska 5, Podgorica  
Tel: + 382 20 406 600  
Fax: + 382 20 655 532  
Faqja elektronike: [www.ear.europa.eu](http://www.ear.europa.eu)

Save the Children UK  
Atinska 54, Podgorica  
Tel/fax: + 382 20 655 015; 655 020

### **Shoqëria Civile:**

Centar Plus  
Ulica Bratstva I jedinstva 65/3, Podgorica  
Tel: +382 68 355 155

CRNVO  
Dalmatinska 22. Podgorica

Tel: +382 20 264 211  
<http://www.crnvo.cg.yu>

Lobimi i Grave Malazeze  
Pete Proleterske bb, Podgorica  
Tel: +382 20 656 166  
[www.cgzenskilobi.org](http://www.cgzenskilobi.org)

Volonterski centar  
Ulica Bratstva i jedinstva broj 57/1, Podgorica  
Tel + 382 20 602 720  
<http://www.zid.cg.yu>